



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.2154/7 prot.

Datë 26.08.2025

V E N D I M
Nr. 1131 /2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 26.08.2025, shqyrtoi kërkesën me:

Objekt: Kërkesë për heqje dorë nga shqyrtimi administrativ i ankesës me nr. Elektronik A/2025/5653 dhe me nr. 2154/2025 prot, datë 11.08.2025, e operatorit ekonomik “Auto Manoku Servis” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me nr. REF-50295-06-05-2025, me objekt: **“Loti 1** “Riparim dhe mirëmbajtje autoambulancash për Qendrën Spitalore Rajonale të Tiranës “Shefqet Ndroqi” “Njësia Tiranë”, me fond limit 41,340,825.00lekë (pa tvsh), zhvilluar me date 14.07.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.

Ankimues: Operatori ekonomik “Auto Manoku Servis” SHPK, me NIPT L62311016C dhe adresë : Rruga Nozllaku, Godine 2 kateshe, Kati 1, Zona Kadastrale 3866,Nr. Pasurie 287/28, Yrshek Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a, me adresë: Rruga ”Reshit Çollaku”, Godina nr.6/337(në krah të Gjykatës së Lartë), Tiranë.

Baza Ligjore: Nenet 30 dhe 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave

nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr.500/2020, datë 05.11.2020 “Rregullore për marrjen e masave organizative për ushtrimin e veprimtarisë së institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID-19”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi kërkesën e ankimuesit dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar si dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

II

Rrethanat e çështjes

II.1 Në datën 06.09.2025 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me nr. REF-50295-06-05-2025, me objekt: “**Loti 1** “Riparim dhe mirëmbajtje autoambulancash për Qendrën Spitalore Rajonale të Tiranës “Shefqet Ndroqi” “Njësia Tiranë”, me fond limit 41,340,825.00lekë (pa tvsh), zhvilluar me date 14.07.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Perqendruara.

II.2. Në datën 08.08.2025 nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. Elektronik A/2025/5653 dhe me nr. 2154/2025 prot, datë 11.08.2025 e operatorit ekonomik “Auto Manoku Servis” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me nr. REF-50295-06-05-2025, me objekt: “**Loti 1** “Riparim dhe mirëmbajtje autoambulancash për Qendrën Spitalore Rajonale

të Tiranës “Shefqet Ndroqi” “Njësia Tiranë”, me fond limit 41,340,825.00lekë (pa tvsh), zhvilluar me date 14.07.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Auto Manoku Servis” SHPK, si dhe mbi vlerësimin me pikë të ofertës së tij teknike të paraqitur në procedurën e sipërpërmendur të prokurimit. Bazuar në nenin 112, pika 4 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik publikoi në datën 11.08.2025 “Formularin për Publikim” me Nr. 2154/1 prot.

II.3. Operatori ekonomik ankimues “Auto Manoku Servis” SHPK, me anë të shkresës me datë 26.08.2025, protokolluar me tonën me nr. 2154/4 prot., datë 26.08.2025, me lëndë “Kërkesë për tu tërhequr nga ankesa” ka paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik një kërkesë me anë të së cilës kërkon të heqë dorë nga ankesa e bërë në lidhje me procedurën e mësipërme të prokurimit duke u shprehur se: *“Ne, “Auto Manoku Servis” shpk, me NIPT L62311016C, me seli në Tirane, Kashar, YRSHEK, Rruga Nozllaku, Godine 2 kateshe, Kati 1, Zona Kadastrale 3866,Nr. Pasurie 287/28, përfaqësuar ligjërisht nga Albert Manoku, në lidhje me ankesën tonë të paraqitur më datë 08.08.2025, me objekt: **Loti 1** “Riparim dhe mirëmbajtje autoambulancash për Qendrën Spitalore Rajonale të Tiranës “Shefqet Ndroqi” “Njësia Tiranë” me nr. reference Loti 1: REF-50295-06-05-2025. në mënyrë vullnetare dhe të ndërgjegjshme, deklarojmë tërheqjen nga ankesa e paraqitur pranë KPP-së. Baza ligjore: Neni 105 i Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullores së detajuar të funksionimit të Komisionit të Prokurimit Publik”, i cili parashikon të drejtën e operatorit ekonomik për të tërhequr ankimimin e paraqitur dhe ndërprerjen e menjëhershme të shqyrtimit të tij. Kërkojmë që Komisioni të marrë në konsideratë këtë tërheqje dhe të ndërpresë procedurat për shqyrtimin e saj.”*

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të kërkesës së operatorit ekonomik ankimues,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me kërkesën e operatorit ekonomik ankimues “Auto Manoku Servis” SHPK për të hequr dorë nga ankesa e bërë në lidhje me procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me nr. REF-50295-06-05-2025, me objekt: **“Loti 1** “Riparim dhe mirëmbajtje autoambulancash për Qendrën Spitalore Rajonale të Tiranës “Shefqet Ndroqi” “Njësia Tiranë”, me fond limit 41,340,825.00lekë (pa tvsh), zhvilluar me date 14.07.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në nenin 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet:

“1. Ankimuesi ka të drejtë që të tërheqë ankesën e depozituar në çdo kohë përpara përfundimit të afatit për shqyrtimin e saj nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Tërheqja e ankesës konsiderohet si mospranim ankese dhe ankimuesit nuk i kthehet tarifa e ankesës.

2. Në rast të tërheqjes së ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik ndërpret shqyrtimin e saj menjëherë dhe merr vendim për mbylljen e çështjes.”

III.1.2. Bazuar në parashikimet e mësipërme ligjore, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik ankimues është në të drejtën e tij, që në çdo kohë përpara përfundimit të afatit për shqyrtimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, të kërkojë të heqë dorë nga pretendimet e parashtruara në ankimimin e tij. Në këto kushte, nisur nga kërkesa e operatorit ekonomik ankimues për heqje dorë nga ankesa e bërë, në zbatim të pikës 2, të nenit 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik do të ndërpresë menjëherë shqyrtimin e ankesës me nr. Elektronik A/2025/5653 dhe me nr. 2154/2025 prot, datë 11.08.2025, për procedurën e prokurimit objekt-ankim, si dhe do të mbyllë çështjen administrative.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të përfundojë procedimin administrativ për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me nr. REF-50295-06-05-2025, me objekt: “**Loti 1** “Riparim dhe mirëmbajtje autoambulancash për Qendrën Spitalore Rajonale të Tiranës “Shefqet Ndroqi” “Njësia Tiranë”, me fond limit 41,340,825.00lekë (pa tvsh), zhvilluar me date 14.07.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Perqendruara.
 2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
 3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Auto Manoku Servis” SHPK.
 4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar	Anëtar	Anëtar
Anila Malaj	Kreshnik Ternova	Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

